



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.165

23 dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MF nr.26, datë 2.12.2011	Për një ndryshim në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar 8333
Udhëzim i MF nr.27, datë 7.12.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” 8333
Urdhër i MB nr.405, datë 22.11.2011	Për delegimin e autoritetit, për miratimin e përdorimit të fondit të veçantë për shpërblimin për rezultate të mira në punë të punonjësve të Policisë së Shtetit 8334
Vendim i ERE nr.108, datë 21.10.2011	Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë 8334
Vendim i ERE nr.109, datë 21.10.2011	Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë 8342
Vendim i ERE nr.110, datë 21.10.2011	Për miratimin e rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike. 8350
Vendim i ERE nr.118, datë 18.11.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të “CEZ shpërndarje” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 8367
Vendim i ERE nr.119, datë 18.11.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 8368

Vendim i ERE nr.120, datë 18.11.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014	8368
Vendim i ERE nr.121, datë 18.11.2011	Për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	8369

UDHËZIM
Nr.26, datë 2.12.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Paragrafi pas shembullit të dytë të pikës 6.2 “Furnizimi i shërbimeve nga jashtë vendit”, me përmbajtjen: “Personi i tatueshëm jorezident në Shqipëri, i cili kryen shërbime, vendi i furnizimit të të cilave është në Shqipëri dhe për rrjedhojë detyrimi për të paguar TVSH-në lind në Shqipëri, në zbatim të nenit 55 të ligjit, i kërkohet të emërojë përfaqësuesin e tij tatimor. Detyrimi i personit të tatueshëm jorezident, për t’u regjistruar me anë të një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri, zbatohet pavarësisht nëse vlera e furnizimit të shërbimit kalon ose jo kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar.”, zhvendoset në fund të pikës 6.1 “Shërbime të lidhura me pasurinë e paluajtshme”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.27, datë 7.12.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 30.11.2007 “PËR PROCEDURAT
E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E INFORMACIONIT DHE
AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË DISPONUESHME, SI DHE
ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005, me propozimin e Komisionit *ad-hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 11 të udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Miratimi i vlerave për artikujt që publikohen në bursën “Reuters”, si dhe në buletine të posaçme, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Të tillë artikuj janë:

a) Artikujt që publikohen në bursën “Reuters”- oriz, sheqer, vaj ushqimor.



- b) Artikulli “Banane”, që publikohen në bursën “Reuters”.
 - c) Autovetura, vlera e të cilave publikohet në buletin “Quattroroute”.
 - d) Automjetet, vlera e të cilave publikohet në buletin “Tutotrasporti”.
 - e) Produktet e çelikut, që publikohen në revistën “Metal-Buleti”.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.405, datë 22.11.2011

PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT, PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË VEÇANTË PËR SHPËRBLIMIN PËR REZULTATE TË MIRA NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 27-33 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, të pikës 2/c të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe të vendimit nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të autoritetit për miratimin e përdorimit të fondit të veçantë, për shpërblimin për rezultate të mira në punë, të punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.108, datë 21.10.2011

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE FAMILJARË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2011, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën e furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë (kontrata, bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
3. Kjo kontratë hyn në fuqi më 1 janar 2012.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

I. PJESA E PARË¹

Kontratë nr. _____.

E lidhur sot më datë _____, në _____ (zonën e shpërndarjes elektrike)

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi _____, i regjistruar si person juridik si një “Shoqëri aksionare”, sipas vendimit nr. _____, datë _____ të QKR, pajisur me numër identifikimi të TVSH _____ dhe me licencën për furnizimin publik me pakicë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. _____, datë _____, në adresën zyrtare: _____ Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga z./zj. _____, nën atributet e drejtorit rajonal të _____.

Dhe

Klienti _____, përfaqësuar _____ (emri, atësia, dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të klientit) në adresën: qytet/fshat _____, seksioni _____, rruga _____, ndërtesa _____, ap. _____, tel. nr. _____, identiteti i të cilit identifikohet nëpërmjet dokumentit të identifikimit të tij: nr. i pasaportës/letërnjoftimit _____.

Pika e livrimit të energjisë.....

Adresa e konsumatorit për shërbimin e dërgimit të faturës.....

Nr. i tel. adresa e e-mail

Palët bien dakord që pjesa e dytë “Termat dhe kushtet” është pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

FURNIZUESI

KLIENTI

II. PJESA E DYTË
TERMAT DHE KUSHTET

Neni 1
Baza ligjore

1.1 Shërbimi i furnizimit me energji elektrike në këtë kontratë ofrohet si shërbim publik në kuadër të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

¹ Miratuar me vendim nr.108, të datës 21.10.2011



Neni 2

Objekti i kontratës

2.1 Objekti i kësaj kontrate është furnizimi i pandërprerë me energji elektrike nga ana e furnizuesit publik me pakicë të klientit familjar dhe detyrimi i klientit për të paguar energjinë elektrike të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.

2.2 Furnizimi me energji elektrike i klientëve tariforë, nga furnizuesi publik me pakicë në pikën e kërkuar nga klienti ofrohet me këto parametra teknikë:

- me fuqi të kërkuar _____ kW ose/limitator _____ A,
- me tension _____ V,
- sistem _____ fazor,
- frekuencë 50 Hz.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

3.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që kërkojnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

3.2 Klienti nuk mund t'u japë apo shesë energji elektrike klientëve të tjerë nga rrjeti i tij. Nuk do të konsiderohet si aktivitet shpërndarjeje i klientit zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i pajisjeve të shpërndarjes të vendosura në pronën e tij private, ose në pronën e tij private të dhënë me qira të tjerëve dhe që përdoren vetëm për të transmetuar ose dhënë energji elektrike te personi që i zotëron, shfrytëzon, administron dhe i kontrollon këto mjete.

3.3 Furnizuesi është i detyruar të mbrojë dhe të mos nxjerrë të dhënat personale të klientit. Të dhënat personale të klientit mund të jepen nga furnizuesi në rastet e mëposhtme:

- me pëlqimin e klientit;
- në rast të respektimit të detyrimeve kontraktuale të furnizuesit në lidhje me përmbushjen e shërbimit të shpërndarjes së faturave të energjisë elektrike dhe/ose arkëtimin e detyrimeve.
- në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Lidhja e kontratës

4.1 Klienti që kërkon lidhjen e kontratës, duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

4.2 Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike çdo subjekt që nuk është debitor ndaj furnizuesit dhe që ka një pikë lidhjeje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e lidhjeve të reja².

4.3 Furnizuesi, pasi ka kontrolluar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën me klientin brenda një muaji nga marrja e kërkesës së klientit.

4.4 Nëse kërkesa e klientit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, furnizuesi, brenda 15 ditësh, do të njoftojë klientin për mungesat e konstatuara. Klienti duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 15-ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë klientin në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

² Shiko www.ere.gov.al
8336

4.5 Për një objekt i cili është furnizuar më parë me energji elektrike, furnizuesi do të sigurojë lidhjen e kontratës së re brenda 10 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar.

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

5.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

5.1.1 Me kërkesë të klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 5.2 e në vijim.

5.1.2 Me iniciativën e furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e klientit të detyrimeve thelbësore të kontratës. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e klientit rastet si më poshtë:

a) Nëse klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së energjisë elektrike.

b) Nëse provohet nga furnizuesi që klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme.

c) Nëse klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësve dhe instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës të tij.

5.2 Nëse klienti kërkon të ndërpresë kontratën e furnizimit me energji elektrike, ai do të njoftojë me shkrim furnizuesin 30 ditë kalendarike përpara, dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet për kundrejt furnizuesit. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtitimit). Klienti nuk është përgjegjës për detyrimet ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit të mësipërm.

5.3 Sipas të njëjtave përcaktime klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij. Furnizuesi do të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim. Klienti do bëjë kërkesë për rilidhjen e energjisë pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

5.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e lidhjes, furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e shkëputjes, duke përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.5 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Neni 6

Çmimi i energjisë elektrike

6.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditura klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

6.2 Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim i çmimit i bërë me vendim të ERE-s, do të aplikohet automatikisht në kontratë. Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 ditë kalendarike përpara aplikimit.



Neni 7

Leximi i matësit dhe faturimi i energjisë elektrike

7.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të klientit për një periudhë kohore prej 30-ditësh kalendarike dhe do t'i dërgojë klientit në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

7.2 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhëna teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të klientit;
- Data e leximit;
- Periudha e faturuar;
- Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Data limit e pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonese;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlera e detajuar e debisë së klientit;
- Informacione të nevojshme për kujdesin ndaj klientit (përfshirë *website*-in e kompanisë, numrat e telefonit, e-mail për ankesat, për defektet, si dhe të ERE).

7.3 Brenda datës 31 dhjetor 2012 furnizuesi është i detyruar të sigurojë aksesin e klientit për leximin e lirë të aparatit matës në çdo kohë.

7.4 Furnizuesi do të sigurojë aksesin *online* të faturës së konsumit për çdo klient duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe faturimit.

Neni 8

Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

8.1 Faturimi i energjisë elektrike për ditët që klientit i është hequr aparati matës për shkak të kontrollit periodik me kërkesë të klientit apo furnizuesit, ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës do të bëhet bazuar në konsumin mesatar ditor të muajit paraardhës, por jo më shumë se 30 ditë.

8.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin 30-ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero.

Neni 9

Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

9.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

9.2 Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës mujore të energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në zyrat e furnizuesit, bankave, zyrave postare apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

9.3 Të gjitha pagesat sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit.

9.4 Sipas marrëveshjes me klientin, faturat mund të dërgohen:

- klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- në adresë të një personi të tretë i cili është përcaktuar si pagues nga klienti sipas pëlqimit të tij.

9.5 Në të gjitha rastet, klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave. Në rast se klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mospagesat e faturave të energjisë.

9.6 Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të klientit, dhe shuma përkatëse, të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të klientit.

Neni 10

Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonese, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Neni 11

Pasojat e mospagesës

11.1 Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga klienti.

11.2 Në rastet e mësipërme njoftimet bëhen në adresën e përcaktuar në kontratë.

11.3 Nëse klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 11.1, atëherë furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike. Në këtë rast furnizuesi vepron sipas përcaktimeve të nenit 5.4 të kësaj kontrate.

Neni 12

Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të energjisë elektrike

12.1 Klienti ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit që lidhet me të drejtat e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon (Call Center) ose në rrugë elektronike.

12.2 Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me rregulloren e trajtimit të ankesave, të miratuar nga ERE. Kjo rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e energjisë elektrike, apo në zyrat e kujdesit ndaj klientit dhe në faqet elektronike të furnizuesit apo të ERE-s.

12.3 Në rast se furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën klientit brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e mësipërme, apo nëse klienti nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë ankesën në ERE, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ERE-s.

12.4 Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga furnizuesi por jo më vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.



12.5 Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit, rezulton se konsumatori është mbifaturuar atëherë furnizuesi:

- i) anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrigtuar;
- ii) në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën e klientit brenda 3 muajve pasardhës.

Në rast të moskompensimit brenda afatit të përcaktuar më sipër, furnizuesi duhet të kompensojë klientin, me një penaltet 0.1 % në ditë, për çdo ditë vonesë, mbi vlerën e diferencës për t'u korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

12.6 Për faturat e kontestuara nga klienti, që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të tij (të krahasueshme ose më shumë se trefishi i faturimit mesatar mujor), furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përsheptuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

Neni 13

Instalimi dhe pronësia

13.1 Furnizuesi, me shpenzimet e veta, instalon te klienti në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate.

13.2 Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik që lidhen me kryerjen e instalimeve elektrike brenda objektit apo banesës së tij.

13.3 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të vendosur nga furnizuesi brenda kufijve të pronës së klientit.

Neni 14

Kontrolli i sistemit matës

14.1 Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të klientit në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

14.2 Kur konstatohet pasaktësi në matje, palët do t'i referohen procedurave për kompensim të parashikuara nga Kodi i Matjes.

14.3 Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga klienti, me qëllim të manipulimit apo mosregjistrimit të saktë të energjisë së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Furnizimi dhe karakteristikat e energjisë elektrike

15.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e energjisë elektrike në rastet e mëposhtme:

- a) Për shkaqe të forcës madhore-ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit.
- b) Ndërprerje për shkak të urdhrave të operatorit të sistemit të transmetimit;
- c) Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;
- d) Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e cilësisë së shërbimit;

e) Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes.

15.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet e parashikuara në germat “a”, “b”, “c”, të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në germat “d” dhe “e” të pikës 15.1, furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE.

15.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuara në rregulloren e mësipërme.

15.4 Në asnjë rast përfitimi i kompensimit nga ana e klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 15.3, nuk e përjashton të drejtën e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

15.5 Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë së tensionit, sipas Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, me këto devijime të lejuara:

- Për kryeqytetin: $\pm 5\%$
- Për zonat urbane: $\pm 5\%$ -15%
- Për zonat rurale: $\pm 5\%$ -20%

15.6 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen klientit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara në pikën 15.5 dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij.

15.7 Përcaktimi i dëmit efektiv të shkaktuar klientit në rastet e pikës 15.6, bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

Neni 16 Detyrime të përbashkëta

16.1 Rrjeti shpërndarës, pajisjet dhe instalimet, duhet t'i përgjigjen kushteve teknike të përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes.

16.2 Pasi të dy palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në prezencë të klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elementë të tjerë të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

- Vulën e kapakut të morseterisë _____
- Vulën e boksit individual _____
- Vulën e limitatorit para matësit _____
- Numrin e serisë së matësit _____
- Leximin aktual të tregimit të matësit _____
- Numrin e fazave të matësit _____
- Emrin e kabinës elektrike nga ku furnizohet _____

- Si dhe një skemë të thjeshtë elektrike të furnizimit përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

16.3 Çdo ndryshim i mëvonshëm i elementeve të përcaktuara në nenin 16.2 do të reflektohen në kontratë.



Neni 17
Ndryshimet e kontratës

17.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERE-s, sipas së njëjtës procedurë të miratimit të tyre. Furnizuesi njofton çdo klient mbi ndryshimet e bëra në kontratë 30 ditë para hyrjes në fuqi të saj.

17.2 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERE dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë konsumatorët tariforë.

17.3 Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e klientit, ai mund të heqë dorë nga kontrata pa asnjë penaltet, pasi ka ekzekutuar më parë të gjitha detyrimet.

Neni 18
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, ose gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 19
Legjislacioni i zbatueshëm

Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo kontratë do të zbatohet Kodi Civil dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi më datë 1 janar 2012.

VENDIM
Nr.109, datë 21.10.2011

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË
KLIENTËVE JOFAMILJARË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.10.2011, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën e furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë (kontrata, bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “Cez shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

3. Kjo kontratë hyn në fuqi në 1 janar 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

I. PJESA E PARË³

Kontratë nr. _____.

E lidhur sot me datë _____, në _____ (zonën e shpërndarjes elektrike)

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi _____, i regjistruar si person juridik si një “Shoqëri aksionare”, sipas vendimit nr. _____, datë _____ të QKR, pajisur me numër identifikimi të TVSH _____ dhe me licencën për furnizimin publik me pakicë të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. _____, datë _____, në adresën zyrtare: _____ Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga z./zj. _____, nën atributet e drejtorit rajonal të _____.

Dhe

Klienti _____, përfaqësuar _____ (emri, atësia, dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të klientit) në adresën: qytet/fshat _____, seksioni, _____, rruga _____, ndërtesa _____, ap. _____, tel. nr. _____, identiteti i të cilit identifikohet nëpërmjet dokumentit të identifikimit të tij: nr. i pasaportës/letërnjoftimit. _____

Pika e livrimit të energjisë.....

Adresa e konsumatorit për shërbimin e dërgimit të faturës.....

Nr. i tel. adresa e e-mail

Palët bien dakord që pjesa e dytë “Termat dhe kushtet” është pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

FURNIZUESI

KLIENTI

II. PJESA E DYTË TERMAT DHE KUSHTET

Neni 1

Baza ligjore

1.1 Shërbimi i furnizimit me energji elektrike në këtë kontratë ofrohet si shërbim publik në kuadër të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

Neni 2

Objekti i kontratës

2.1 Objekti i kësaj kontrate është furnizimi i pandërprerë me energji elektrike nga ana e furnizuesit publik me pakicë të klientit familjar dhe detyrimi i klientit për të paguar energjinë elektrike të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.

³ Miratuar me vendim nr.109, datë 21.10.2011



2.2 Furnizimi me energji elektrike i klientëve tariforë, nga furnizuesi publik me pakicë në pikën e kërkuar nga klienti ofrohet me këto parametra teknikë:

- me fuqi të kërkuar _____ KW ose/limitator _____ A,
- me tension _____ V,
- sistem _____ fazor,
- frekuencë 50 Hz.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

3.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që kërkojnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

3.2 Klienti nuk mund t'u japë apo shesë energji elektrike klientëve të tjerë nga rrjeti i tij. Nuk do të konsiderohet si aktivitet shpërndarjeje i klientit zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i pajisjeve të shpërndarjes të vendosura në pronën e tij private, ose në pronën e tij private të dhënë me qira të tjerëve dhe që përdoren vetëm për të transmetuar ose dhënë energji elektrike te personi që i zotëron, shfrytëzon, administron dhe i kontrollon këto mjete.

3.3 Furnizuesi është i detyruar të mbrojë dhe të mos nxjerrë të dhënat personale të klientit. Të dhënat personale të klientit mund të jepen nga furnizuesi në rastet e mëposhtme:

- Me pëlqimin e klientit;
- Në rast të respektimit të detyrimeve kontraktuale të furnizuesit në lidhje me përmbushjen e shërbimit të shpërndarjes së faturave të energjisë elektrike dhe/ose arkëtimin e detyrimeve.
- Në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Lidhja e kontratës

4.1 Klienti që kërkon lidhjen e kontratës duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

4.2 Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike çdo subjekt që nuk është debitor ndaj furnizuesit dhe që ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e lidhjeve të reja⁴.

4.3 Para nënshkrimit të kontratës furnizuesi ka të drejtë të kërkojë lëshimin e një garancie në formën e një depozite bankare në një vlerë të barabartë me shumën që i korrespondon konsumit mesatar të dy muajve, si garanci për përmbushjen në kohë të detyrimeve të pagesës së energjisë elektrike.

4.4 Furnizuesi pasi ka kontrolluar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën me klientin brenda një muaji nga marrja e kërkesës së klientit.

4.5 Nëse kërkesa e klientit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, furnizuesi brenda 15 ditësh, do të njoftojë klientin për mungesat e konstatuara. Klienti duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 15-ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë klientin në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

4.6 Për një objekt i cili është furnizuar me parë me energji elektrike, furnizuesi do të sigurojë lidhjen e kontratës së re brenda 10 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar.

⁴ Shiko www.ere.gov.al
8344

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

5.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

5.1.1 Me kërkesë të klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 5.2 e në vijim.

5.1.2 Me iniciativën e furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e klientit të detyrimeve thelbësore të kontratës. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e klientit rastet si më poshtë:

a) Nëse klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së energjisë elektrike.

b) Nëse provohet nga furnizuesi që klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme.

c) Nëse klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësve dhe instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës së tij.

5.2 Nëse klienti kërkon të ndërpresë kontratën e furnizimit me energji elektrike, ai do të njoftojë me shkrim furnizuesin 30 ditë kalendarike përpara, dhe do të likujdojë të gjitha detyrimet përkundrejt furnizuesit. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtimit). Klienti nuk është përgjegjës për detyrimet ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit të mësipërm.

5.3 Sipas të njëjtave përcaktime, klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij. Furnizuesi do të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim. Klienti do të bëjë kërkesë për rilidhjen e energjisë pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

5.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e lidhjes, furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e shkëputjes, duke përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.5 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Neni 6

Çmimi i energjisë elektrike

6.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditura klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

6.2 Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim i çmimit i bërë me vendim të ERE-s, do të aplikohet automatikisht në kontratë. Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 ditë kalendarike përpara aplikimit.

Neni 7

Leximi i matësit dhe faturimi i energjisë elektrike

7.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të klientit për një periudhë kohore prej 30-ditësh kalendarike dhe do t'i dërgojë klientit në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.



7.2 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të klientit;
- Data e leximit;
- Periudha e faturuar;
- Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Data limit e pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlera e detajuar e debisë së klientit;
- Informacione të nevojshme për kujdesin ndaj klientit (përfshirë *website*-in e kompanisë, numrat e telefonit, e-mail për ankesat, për defektet si dhe të ERE).

7.3 Brenda datës 31 dhjetor 2012, furnizuesi është i detyruar të sigurojë aksesin e klientit për leximin e lirë të aparatit matës në çdo kohë.

7.4 Furnizuesi do të sigurojë aksesin online të faturës së konsumit për çdo klient duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe faturimit.

Neni 8

Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

8.1 Faturimi i energjisë elektrike për ditët që klientit i është hequr aparati matës për shkak të kontrollit periodik me kërkesë të klientit apo furnizuesit, ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës do të bëhet bazuar në konsumin mesatar ditor të muajit paraardhës, por jo më shumë se 30 ditë.

8.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin 30-ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero.

Neni 9

Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

9.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

9.2 Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës mujore të energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në zyrat e furnizuesit, bankave, zyra postare, apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

9.3 Të gjitha pagesat sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit.

9.4 Sipas marrëveshjes me klientin faturat mund të dërgohen:

- Klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- Në adresë të një personi të tretë i cili është përcaktuar si pages nga klienti sipas pëlqimit të tij.

9.5 Në të gjitha rastet, klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave. Në rast se klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mospagesat e faturave të energjisë.

9.6 Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të klientit, dhe shuma përkatëse, të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të klientit.

Neni 10

Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Neni 11

Pasojat e mospagesës

11.1 Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga klienti.

11.2 Në rastet e mësipërme njoftimet bëhen në adresën e përcaktuar në kontratë.

11.3 Nëse klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 11.1, atëherë furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike. Në këtë rast furnizuesi vepron sipas përcaktimeve të nenit 5.4 të kësaj kontrate.

Neni 12

Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të energjisë elektrike

12.1 Klienti ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit që lidhet me drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon (Call Center) ose në rrugë elektronike.

12.2 Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me rregulloren e trajtimit të ankesave, të miratuar nga ERE. Kjo rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e energjisë elektrike, apo në zyrat e kujdesit ndaj klientit dhe në faqet elektronike të furnizuesit apo të ERE-s.

12.3 Në rast se furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën klientit brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e mësipërme, apo nëse klienti nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë ankesën në ERE, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ERE-s.

12.4 Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga furnizuesi, por jo më vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

12.5 Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit, rezulton se konsumatori është mbifaturuar atëherë furnizuesi:

- i) anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrigtuar;



ii) në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën e klientit brenda 3 muajve pasardhës.

Në rast të moskompensimit brenda afatit të përcaktuar më sipër, furnizuesi, duhet të kompensojë klientin, me një penalitet 0.1 % në ditë, për çdo ditë vonesë, mbi vlerën e diferencës për t'u korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

12.6 Për faturat e kontestuara nga klienti, që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të tij (të krahasueshme ose më shumë se trefishi i faturimit mesatar mujor), furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përshpejtuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

Neni 13

Instalimi dhe pronësia

13.1 Furnizuesi, me shpenzimet e veta, instalon te klienti në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate.

13.2 Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik që lidhen me kryerjen e instalimeve elektrike brenda objektit apo banesës së tij.

13.3 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të vendosur nga furnizuesi brenda kufijve të pronës së klientit.

Neni 14

Kontrolli i sistemit matës

14.1 Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të klientit në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

14.2 Kur konstatohet pasaktësi në matje, palët do t'u referohen procedurave për kompensim të parashikuara nga kodi i matjes.

14.3 Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga klienti, me qëllim të manipulimit apo mosregjistrimit të saktë të energjisë së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Furnizimi dhe karakteristikat e energjisë elektrike

15.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin e pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e energjisë elektrike në rastet e mëposhtme:

a) Për shkaqe të forcës madhore - ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit;

b) Ndërprerje për shkak të urdhrave të operatorit të sistemit të transmetimit;

c) Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;

d) Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e cilësisë së shërbimit;

e) Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes.

15.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet e parashikuara në gerrat “a”, “b”, “c” të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në gerrat “d” dhe “e” të pikës 15.1, furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE.

15.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuara në rregulloren e mësipërme.

15.4 Në asnjë rast përfitimi i kompensimit nga ana e klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 15.3, nuk e përjashton të drejtën e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

15.5 Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë së tensionit, sipas Kodit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, me këto devijime të lejuara:

- Për kryeqytetin : +/-5%
- Për zonat urbane : +5/-15%
- Për zonat rurale : +5/-20%

15.6 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen klientit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara në pikën 15.5 dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij.

15.7 Përcaktimi i dëmit efektiv të shkaktuar klientit në rastet e pikës 15.6, bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

Neni 16

Detyrime të përbashkëta

16.1 Rrjeti shpërndarës, pajisjet dhe instalimet, duhet t'i përgjigjen kushteve teknike të përcaktuara në kodin e shpërndarjes.

16.2 Pasi të dyja palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në prezencë të klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elemente të tjera të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

- Vulën e kapakut të morseterisë _____
- Vulën e boksit individual _____
- Vulën e limitatorit para matësit _____
- Numrin e serisë së matësit _____
- Leximin aktual të tregimit të matësit _____
- Numrin e fazave të matësit _____
- Emrin e kabinës elektrike nga ku furnizohet _____

- Si dhe një skemë të thjeshtë elektrike të furnizimit përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

16.3 Çdo ndryshim i mëvonshëm i elementeve të përcaktuara në nenin 16.2 do të reflektohen në kontratë.



Neni 17 **Ndryshimet e kontratës**

17.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERE-s, sipas të njëjtës procedurë të miratimit të tyre. Furnizuesi njofton çdo klient mbi ndryshimet e bëra në kontratë 30 ditë para hyrjes në fuqi të saj.

17.2 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERE dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë konsumatorët tariforë.

17.3 Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e klientit, ai mund të heqë dorë nga kontrata pa asnjë penaltet, pasi ka ekzekutuar më parë të gjitha detyrimet.

Neni 18 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, ose gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 19 **Legjislacioni i zbatueshëm**

Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo kontratë do të zbatohet Kodi Civil dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë hyn në fuqi më datë 1 janar 2012.

VENDIM **Nr.110, datë 21.10.2011**

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES DHE SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 dhe 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.10.2011, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të tij dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike (rregullorja, bashkëngjitur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

3. Kjo rregullore hyn në fuqi në 1 janar 2012.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

RREGULLORE
PËR KUSHTET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES DHE
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE⁵

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të:

- Nenit 8.2/g të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar);
- Deklaratës rregullatore, pika 7;
- Ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, neni 40;
- Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
- Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

Neni 2
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim:

- Të krijojë kushtet e një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë (brenda limiteve të lejuara të përcaktuara në këtë rregullore) me energji elektrike, të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Të përcaktojë treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- Të përcaktojë rregullat për vazhdueshmërinë e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet evidentimit të ndërprerjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, si dhe klasifikimin e ndërprerjeve.
- Të përcaktojë parametrat e cilësisë së energjisë së furnizuar.
- Të përcaktojë limitet e lejuara të ndërprerjeve të energjisë elektrike sipas kategorive të ndërprerjeve.
- Të përcaktojë rregullat e cilësisë tregtare të shërbimit.
- Të përcaktojë detyrimet dhe të drejtat e furnizuesit të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe konsumatorit të energjisë elektrike në këtë sistem.
- Të përcaktojë rregullat dhe detyrimet e ndërsjella në rastet e mosrespektimit të detyrimeve të furnizuesit me energji elektrike dhe përfituesit të shërbimit, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

⁵ Miratuar me vendimin nr.110 të Bordit të Komisionerëve, datë 21.10.2011



PJESA I RREGULLAT E VAZHDUESHMËRISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 3

Parime të përgjithshme për vazhdueshmërinë e furnizimit me energji elektrike

3.1 Pjesa e I-rë e kësaj rregulloreje ka për qëllim:

a) të sigurojë një regjistrim korrekt të ndërprerjeve të energjisë elektrike të shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, për të pasur tregues të performancës për sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit. Treguesit duhet të jenë të besueshëm, të krahasueshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm, në mënyrë që informacioni të jetë i saktë për klientët dhe të interesuarit e tjerë lidhur me vazhdueshmërinë e furnizimit;

b) të përmirësojë vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit në nivel kombëtar dhe për të ulur diferencat ndërmjet zonave të ndryshme të furnizimit;

c) të kufizojë numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve vjetore që pësojnë klientët, duke i siguruar një rimbursim të përcaktuar në rastet e tejkalimit të standardeve specifike të përcaktuara në këtë rregullore;

d) të favorizojë lidhjen e kontratave për një nivel të vazhdueshmërisë së shërbimit dhe të cilësisë së tensionit, më të lartë se ai i përcaktuar nga ERE.

3.2 Për sa i takon vazhdueshmërisë së furnizimit dhe cilësisë së tensionit, shoqëria e shpërndarjes nuk mund të zbatojë kushte diskriminuese midis klientëve fundorë të furnizuar në të njëjtin nivel tensioni dhe me të njëjtën vendndodhje, pa përjashtuar këtu të drejtën për të përcaktuar nivele më të larta të cilësisë së shërbimit nëpërmjet kontratave të veçanta të lidhura midis shoqërisë së shpërndarjes dhe klientëve fundorë ose subjekteve të tjera të interesuara.

Neni 4

Detyrimi për regjistrimin e ndërprerjeve

4.1 Shoqëria e shpërndarjes kryen regjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon.

4.2. Sistemi i regjistrimit të vazhdueshmërisë së shërbimit duhet të funksionojë për të gjitha linjat TL dhe TM të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe impiantet e transformimit.

4.3 Shoqëria e shpërndarjes regjistron ndërprerjet e energjisë elektrike në TU sipas informacioneve nga përdoruesit dhe metodave reale që disponon.

4.4. Shoqëria e shpërndarjes organizon strukturën përkatëse për regjistrimin e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike në sistemin e shpërndarjes. Regjistrimi i të dhënave duhet të lejojë transmetimin e tyre në formë elektronike.

Neni 5

Regjistri i ndërprerjeve

5.1 Shoqëria e shpërndarjes mban regjistrin e ndërprerjeve për të gjitha llojet e ndërprerjeve të përmendura më sipër, i cili duhet të përmbajë:

a) origjinën e ndërprerjes;

b) shkakun e ndërprerjes;

c) numrin e klientëve në TL të përfshirë në ndërprerje;

- d) kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje;
- e) numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- f) kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- g) numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- h) kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rilidhjes, të ndarë sipas kategorive;
- i) datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje.

5.2 Shoqëria e shpërndarjes siguron aksesin në informacionin që përmban regjistri i ndërprerjeve, për të gjithë klientët fundorë të interesuar, për institucionin e mbrojtjes së konsumatorit dhe për subjektet përgjegjëse për aktivitetin e matjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

Neni 6

Llojet e ndërprerjes

Për efekt klasifikimi, ndërprerjet mund të jenë: ndërprerje të gjata dhe ndërprerje të shkurtra.

- Çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë.
- Çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më pak se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e shkurtër.

Neni 7

Vlerësimi i llojit të ndërprerjes

Në vlerësimin e llojit të ndërprerjes, shoqëria e shpërndarjes zbaton edhe këto kritere:

- a) Kriteri i bashkimit të kohëzgjatjes - kur dy ose më shumë ndërprerje të gjata apo të shkurtra, shkaktuar të njëjtit klient fundor, për të njëjtin shkak dhe për të njëjtën origjinë, ndodhin brenda 60 minutave njëra nga tjetra, ato bashkohen si një ndërprerje e vetme e barabartë me shumën e ndërprerjeve të veçanta.
- b) Kriteri i kohëzgjatjes - kur sipas kriterit të bashkimit të përcaktuar në pikën “a” më sipër, disa klientëve u ndodh ndërprerja për më pak se 10 minuta dhe të tjerëve për më shumë se 10 minuta, shoqëria e shpërndarjes i konsideron ndërprerje të shkurtra për grupin e parë të klientëve dhe ndërprerje të gjata për grupin e dytë të klientëve.
- c) Kriteri i njësimit të shkakut dhe origjinës – kur ndërprerja e regjistruar ndodh, në kufirin e 15 minutave nga momenti i ndryshimit të shkakut apo origjinës së ndërprerjes, për të njëjtin shkak dhe për të njëjtën origjinë, kjo ndërprerje konsiderohet si një ndërprerje e vetme, sipas shkakut dhe origjinës fillestare të ndërprerjes.

Neni 8

Klasifikimi i zonave

Për efekt të regjistrimit të ndërprerjeve dhe të përpunimit të të dhënave të treguesve të vazhdueshmërisë për klientët në TM dhe TU, bëhet ky klasifikim i zonave të furnizimit me energji elektrike nga shoqëria e shpërndarjes:

- a) kryeqyteti;
- b) zona urbane – territori i bashkive (të klasifikuara si të tilla sipas ndarjes territoriale administrative zyrtare);



c) zona rurale – territori i komunave (të klasifikuara si të tilla sipas ndarjes territoriale administrative zyrtare).

Neni 9 Origjina e ndërprerjes

9.1 Shoqëria e shpërndarjes klasifikon ndërprerjet në bazë të sektorit të rrjetit elektrik në të cilin ka origjinë ndërprerja, sipas këtyre përkufizimeve:

a) Ndërprerje me origjinë “Sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, për shkak të urdhrave nga operatori i sistemit të transmetimit, për motive të sigurisë të sistemit elektrik;

b) Ndërprerje me origjinë në sistemin e transmetimit, në linjat dhe impiantet që i përkasin këtij rrjeti;

c) Ndërprerje me origjinë në rrjetin e TL të shoqërisë së shpërndarjes, në linjat dhe impiantet e transformimit, duke përfshirë linjat dhe impiantet që i përkasin rrjetit elektrik të transmetimit;

d) Ndërprerje me origjinë në rrjetin e TM të shoqërisë së shpërndarjes, në linjat dhe impiantet e transformimit, përfshirë sistemin e matjes të klientëve në TM e të impianteve të transformimit TM/TU (vetëm nga ana e TM);

e) Ndërprerje me origjinë në rrjetin e TU të shoqërisë së shpërndarjes, në linjat dhe impiantet e transformimit, përfshirë sistemin e matjes së klientëve në TU e të impianteve të transformimit TM/TU (duke përfshirë anën e TM), dhe çdo ndërprerje që përfshin më shumë se një klient në TU, në sistemet e matjes së centralizuar (boks kolektiv).

9.2 Ndërprerjet në sistemin e matjes së klientëve në TU, edhe pse në bokse kolektive, që përfshijnë vetëm një klient në TU, nuk numërohen për qëllime të treguesve të vazhdueshmërisë së furnizimit, por regjistrohen për efekt të treguesve të cilësisë tregtare për të verifikuar standardet specifike të aplikuara ndaj tyre.

Neni 10 Shkakut i ndërprerjes

Shoqëria e shpërndarjes regjistron shkakun e çdo ndërprerjeje, me përjashtim të ndërprerjeve me origjinë “Sistemin elektrik të transmetimit”, sipas këtyre përcaktimeve:

a) Ndërprerje nga forcat madhore - ndërprerjet e jashtëzakonshme, të shkaktuara sipas rasteve të përcaktuara në ligj.

b) Ndërprerje nga shkaqe të jashtme - dëme të shkaktuara nga klientët, kontakte të rastësishme apo dëmtime të përcjellësve të provokuar nga të tretët, dëme të provokuara në impiantet e prodhimit.

c) Ndërprerje nga defekte në sistemin e shpërndarjes - përfaqësojnë defekte teknike në linjat elektrike të shpërndarjes, në impiantet transformuese dhe në sistemet e matjes së energjisë elektrike.

d) Ndërprerje për efekt të kërkesave të sigurimit teknik - përfaqësojnë ndërprerje që imponohen nga situata të rrezikut për jetën ose të pasurisë në sistemin elektrik të shpërndarjes.

e) Ndërprerje të planifikuara - përfaqësojnë ndërprerjet që kryhen për efekt të remonteve të planifikuara, rikonstruksioneve ose ndërtimeve të reja në sistemin elektrik të shpërndarjes.

f) Ndërprerje nga shkaqe të tjera - shkaqe që nuk janë të përfshira në germet “a” – “e”, më sipër.

Neni 11

Dokumentimi i ndërprerjeve të planifikuara

Shoqëria e shpërndarjes dokumenton fillimin e ndërprerjeve të planifikuara nëpërmjet regjistrimit sipas kërkesave përkatëse të rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik të sistemit të shpërndarjes.

Neni 12

Regjistrimi i kohëzgjatjes për klientët e përfshirë në ndërprerje

Për secilin klient të përfshirë në një ndërprerje të planifikuar ose të paplanifikuar, të gjatë ose të shkurtër, shoqëria e shpërndarjes regjistron kohëzgjatjen e ndërprerjes, si koha ndërmjet fillimit të ndërprerjes, sipas përcaktimeve të nenit 7 më sipër, dhe fundit të ndërprerjes, që korrespondon me rilidhjen përfundimtare të të njëjtit klient.

Neni 13

Verifikimi i informacionit të regjistruar

Shoqëria e shpërndarjes mban dhe përditëson regjistrin e ndërprerjeve. Lista e klientëve në TU të përfshirë në ndërprerje, duhet të jetë lehtësisht e verifikueshme dhe e hapur për t'u riprodhuar mbi bazë kërkesë.

Neni 14

Treguesit e vazhdueshmërisë së shërbimit

14.1 Duke iu referuar vitit kalendarik, përcaktohen këta tregues të vazhdueshmërisë së shërbimit:

- a) Numri i ndërprerjeve për klient, për ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara, të gjata apo të shkurtra;
- b) Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjes për klient, vetëm për ndërprerjet e planifikuara dhe për ndërprerjet e gjata të paplanifikuara.

14.2 Koeficienti i ndërprerjes së energjisë elektrike për klient gjatë një viti, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIFI = \frac{\sum_{i=1}^k N_i}{N_T}$$

SAIFI – (System Average Interruption Frequency Index) koeficienti i ndërprerjes për klient.

- N_i - numri i klientëve të përfshirë në ndërprerjen “i”.
- N_T - numri total i klientëve të furnizuar gjatë atij viti.
- K - numri total i ndërprerjeve.

14.3 Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjes për klient, që lidhet në ndërprerjet e planifikuara dhe ndërprerjet e gjata të paplanifikuara, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \cdot N_i}{N_T}$$



SAIDI - (System Average Interruption Duration Index) koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes për klient.

- Ni - është numri i klientëve të përfshirë në ndërprerjen “i”.
- NT – numri total i klientëve të furnizuar gjatë atij viti.
- Di - kohëzgjatja e ndërprerjes i.
- K - numri total i ndërprerjeve.

Neni 15

Kohëzgjatja dhe numri vjetor i ndërprerjeve të gjata të paplanifikuara

15.1 Indeksi “D1” tregon kohëzgjatjen totale të ndërprerjeve të gjata të paplanifikuara gjatë një viti për një klient në TL, TM siç përcaktohen në nenin 6, që i referohet ndërprerjeve me origjinë siç është përcaktuar në nenin 10 pika “f” të kësaj rregulloreje.

15.2 Indeksi “N1” tregon numrin total të ndërprerjeve të gjata të paplanifikuara gjatë një viti, për një klient në TL dhe TM siç përcaktohen në nenin 6, që i referohet ndërprerjeve me origjinë siç është përcaktuar në nenin 10 pika “f” të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Niveli i lejuar i treguesve “D1” dhe “N1”

16.1 Duke filluar nga 1 janari i vitit 2012, përcaktohen këto nivele të lejuara për treguesin “D1”, për ndërprerjet e shkaktuara në rrjetin e tensionit 20 kV e lart për 1 vit:

- a) Për kryeqytetin – 2 orë/klient;
- b) Për zonat urbane – 4 orë/klient;
- c) Për zonat rurale – 24 orë/klient.

16.2 Duke filluar nga 1 janari i vitit 2012, përcaktohen këto nivele të lejuara për treguesin “N1”, për ndërprerjet e shkaktuara në rrjetin e tensionit 20 kV e lart për 1 vit:

- a) Për kryeqytetin – 2 ndërprerje;
- b) Për zonat urbane – 5 ndërprerje;
- c) Për zonat rurale – 10 ndërprerje.

16.3 Treguesit “D1” dhe “N1”, sipas pikës 16.1 dhe 16.2, do të llogariten për të gjithë klientët duke filluar nga 1 janari 2015.

Neni 17

Komunikimi tek ERE dhe tek klientët fundorë të vlerave të treguesve të vazhdueshmërisë së furnizimit

17.1 Shoqëria e shpërndarjes i komunikon ERE-s rezultatet e përpunuara të treguesve të cilësisë së vazhdueshmërisë së furnizimit, sipas specifikimeve të nenit 10 të kësaj rregulloreje, për çdo zonë shpërndarjeje të klasifikuar, brenda 31 marsit të vitit pasardhës. Për këtë qëllim, shoqëria e shpërndarjes komunikon numrin e klientëve të energjisë të furnizuar, të ndarë sipas zonave territoriale, për:

- a) klientë familjarë në TU;
- b) klientë jofamiljarë në TU;
- c) klientë në TM;
- d) klientë në TL.

17.2 Shoqëria e shpërndarjes është përgjegjëse për vërtetësinë e informacionit të dërguar dhe është subjekt i verifikimit të regjistrimeve që kanë kontribuar në llogaritjen e treguesve. Për këtë qëllim, komunikimit i bashkëlidhet kopje në format elektronik të regjistrit të ndërprerjes, të ndarë sipas zonave territoriale, sipas tabelës 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

17.3 Këto komunikime dhe informacione publikohen në *website* të shoqërisë së shpërndarjes.

Neni 18

Kontrolli mbi të dhënat e vazhdueshmërisë të deklaruara nga shoqëria e shpërndarjes

18.1 Në qoftë se ERE, në bazë të kontrolleve të kryera për të dhënat e deklaruara mbi vazhdueshmërinë e furnizimit të ofruar nga shoqëria e shpërndarjes sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje, konstaton se këto të dhëna nuk janë regjistruar sipas modaliteteve të parashikuara në këtë rregullore, ERE përcakton, mbi bazën e rezultateve të kontrolleve të kryera, vlerat e supozuara të treguesve të cilësisë për zonën territoriale përkatëse.

18.2 Vlerat e treguesve të llogaritura sipas paragrafit të mësipërm sipas tabelës 1, do të merren si bazë për llogaritjen e penaliteteve të parashikuara.

Neni 19

Ndërprerjet e planifikuara

19.1 Shoqëria e shpërndarjes, në rastet e kryerjes së ndërprerjeve të planifikuara për shkak të ekzekutimit të ndërhyrjeve dhe punimeve të programuara në rrjetin e shpërndarjes, në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, lajmëron klientët e interesuar, me mjetet e përshtatshme të komunikimit publik, për të siguruar informimin e tyre, në një kohë paraprake:

a) të paktën 24 orë-në rastet e ndërprerjes së furnizimit për shkak të situatave të emergjencës apo dëmtimeve;

b) të paktën 48 orë - për të gjitha rastet e tjera.

19.2 Njoftimi përmban këto informacione:

a) datën e ndërprerjes së planifikuar;

b) kohën e planifikuar të fillimit të ndërprerjes dhe kohën e parashikuar të përfundimit të ndërprerjes;

c) datën e komunikimit të njoftimit.

19.3 Shoqëria e shpërndarjes respekton kohën e fillimit dhe të përfundimit të ndërprerjes të përcaktuara në njoftim:

a) çasti i fillimit të ndërprerjes nuk duhet të ndodhë më përpara se 5 minuta nga sa është përcaktuar në njoftim;

b) çasti i përfundimit të ndërprerjes nuk duhet të zgjatet për një kohë më të madhe se 5 minuta nga sa është përcaktuar në njoftim.

19.4 Nëse shoqëria e shpërndarjes shkel kohën e përcaktuar në njoftim më shumë se sa është përcaktuar në germa "a" dhe "b" të paragrafit më sipër, kohëzgjatja e ndërprerjes për klient dhe numri i ndërprerjes për klient, në tejkallim të çastit të fillimit dhe të përfundimit të përcaktuara në njoftim, u shtohen treguesve të përcaktuar në nenet 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.



Neni 20

Kontrata të veçanta për cilësinë e shërbimit

20.1 Shoqëria e shpërndarjes mund të lidhë kontrata të veçanta për cilësinë e shërbimit, me klient fundorë, konsumatorë të mëdhenj, përdorues të tjerë të rrjetit të shpërndarjes, prodhues të energjisë elektrike apo vetëprodhues.

20.2 Kontratat e veçanta për cilësinë, nuk mund të kenë për objekt nivele të cilësisë më të ulëta nga ato të përcaktuara nga ERE, sipas kësaj rregulloreje.

20.3 Në kontratat e veçanta për cilësinë e shërbimit, palët përcaktojnë nivelin e cilësisë, të cilin shoqëria e shpërndarjes bie dakord ta respektojë, si dhe penalitetet në rast të mospërbushjes së tyre nga ana e shoqërisë së shpërndarjes, duke treguar edhe rastet e përjashtimit.

20.4 Në referencë të treguesve për të cilët është e nevojshme një sistem i veçantë matjeje, palët bien dakord për vendosjen e këtij sistemi matjeje të paktën një vit përpara lidhjes së kontratës për cilësinë.

20.5 Të gjitha kostot suplementare për realizimin e cilësisë më të lartë të shërbimit, janë në ngarkim të palës e cila kërkon të përdorë nivele më të larta të cilësisë së shërbimit dhe përcaktohen në marrëveshjen për kushtet e veçanta të shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

20.6 Brenda datës 31 mars shoqëria e shpërndarjes, dërgon në ERE një raport për çdo kontratë të cilësisë së veçantë të lidhur vitin paraardhës, me këtë përmbajtje:

- të dhënat e klientit;
- niveli i tensionit dhe fuqia;
- data e lidhjes së kontratës dhe kohëzgjatja e saj;
- treguesit e nivelit të cilësisë së shërbimit për të cilat është rënë dakord;
- vlera e paguar për shërbimin;
- vlerat e dëmshpërblimeve që do t'i paguhen klientit në rast të mospërbushjes së kontratës.

PJESA II

RREGULLAT E TREGUESVE TË VEÇANTË DHE TË PËRGJITHSHËM TË CILËSISË TREGTARE TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES, MATJES DHE SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 21

Qëllimi dhe parime të përgjithshme për cilësinë tregtare të shërbimit

Pjesa e dytë e kësaj rregulloreje ka për qëllim:

a) Të mbikëqyrë të drejtat e klientëve fundorë nëpërmjet niveleve të veçanta dhe të përgjithshme të cilësisë tregtare të shërbimit të shpërndarjes, të matjes dhe të shitjes së energjisë elektrike dhe dëmshpërblim automatik për kërkuesin në rast të mosrespektimit të niveleve të veçanta të cilësisë për faj të shoqërisë së shpërndarjes;

b) Të sigurojë një regjistrim korrekt dhe të unifikuar të shërbimeve të kërkuara nga klientët për të disponuar tregues të cilësisë tregtare të besueshme, të krahasueshme e të verifikueshme dhe për t'i dhënë një informacion të përshtatshëm klientëve në lidhje me mënyrën e kryerjes së shërbimeve të kërkuara.

Neni 22

Treguesit e cilësisë tregtare të shërbimit

Për të përcaktuar nivelet e veçanta dhe të përgjithshme të cilësisë tregtare të shërbimit të shpërndarjes dhe matjes së energjisë elektrike, u referohemi treguesve të mëposhtëm të cilësisë:

- Koha e realizimit të preventivit për realizimin e punimeve në tension të mesëm dhe të ulët;
- Koha e kryerjes së punimeve të thjeshta dhe komplekse;
- Koha për furnizimin me energji elektrike;
- Koha për ndërprerjen e furnizimit me kërkesë të klientëve fundorë;
- Koha për rilidhjen e energjisë elektrike për shkak të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura;
- Koha për verifikimin e cilësisë së tensionit me kërkesë të klientit fundor;
- Koha e përgjigjes për ankesat e klientëve apo kërkesat me shkrim për informacione që lidhen me shërbimin e shpërndarjes, furnizimit apo matjes së energjisë elektrike;
- Koha e rivendosjes së furnizimit pas një defekti të sistemit të matjes;
- Koha e kryerjes së kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit fundor.

Neni 23

Koha e përgatitjes së preventivit për realizimin e punimeve në tension të mesëm dhe të ulët me kërkesë të konsumatorit

Koha e realizimit të preventivit për kryerjen e punimeve në tension të mesëm dhe të ulët, me kërkesë të konsumatorit, është koha e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes të kërkesës për kryerjen e preventivit dhe datës që vihet në dispozicion të klientit preventivi i kërkuar (shiko tabelën nr.2).

Neni 24

Koha e kryerjes së punimeve të thjeshta dhe komplekse

24.1 Koha e kryerjes së punimeve të thjeshta dhe komplekse është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes së kërkesës nga ana e klientit për fillimin e punimeve, sipas preventivit të pranuar prej tij, dhe datës së përfundimit të punimeve të kërkuara.

- 24.2 Janë të përfshirë nga aplikimi i këtij neni, këto punime komplekse:
- elektrifikimi i zonave urbanistike (qendra të banuara, industriale apo rurale) të realizuara me kërkesë nga subjekte të ndryshme nga klientët fundorë;
 - kërkesa për spostim të bëra nga një kërkuar i ndryshëm nga klienti fundor.

Neni 25

Koha për aktivizimin e furnizimit me energji elektrike

Koha e aktivizimit të furnizimit me energji elektrike është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes të kërkesës për aktivizimin e furnizimit, e dërguar nga kërkuar dhe data e aktivizimit të furnizimit deri në sistemin e matjes.

Neni 26

Koha e ndërprerjes së furnizimit me kërkesë të klientëve fundorë

Koha e ndërprerjes së furnizimit me kërkesë të klientëve fundorë është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes së kërkesës për ndërprerjen e furnizimit të dërguar nga kërkuar dhe datës së kryerjes së ndërprerjes së furnizimit.



Neni 27

Koha për rilidhjen e energjisë elektrike për shkak të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

Koha për rilidhjen e energjisë elektrike për shkak të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes të dokumentimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe datës së rilidhjes së energjisë elektrike.

Neni 28

Koha e verifikimit të cilësisë së tensionit me kërkesë të klientit fundor

28.1 Koha për verifikimin e cilësisë së tensionit me kërkesë të klientit fundor është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes së kërkesës për verifikim të cilësisë së tensionit nga ana e klientit dhe datës që i vihet në dispozicion kërkuarit, dokumentacioni i verifikimit të kryer.

28.2 Shoqëria e shpërndarjes duhet të kryejë një verifikim të cilësisë së tensionit për respektimin e limiteve të variacioneve të tensionit të vendosura sipas kësaj rregulloreje, nëpërmjet instalimit të një pajisjeje të regjistrimit, për jo më pak se 48 orë.

28.3 Në rast se nuk janë regjistruar vlera të tensionit në përputhje me normat dhe afatet e përcaktuara në këtë rregullore, shoqëria e shpërndarjes njofton kërkuarin për datën e parashikuar të rivendosjes së vlerave korrekte të tensionit të furnizimit.

28.4 Në rast se normat e regjistruara janë në përputhje me vlerat e tensionit të lejuar në këtë rregullore, atëherë kostot për këtë shërbim i ngarkohen klientit, i cili kërkon verifikimin e cilësisë së tensionit.

Neni 29

Koha e përgjigjes për ankesat e klientëve apo kërkesat me shkrim për informacion

Koha e përgjigjes për ankesat e klientëve apo kërkesat me shkrim për informacion është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes së ankesës apo kërkesës me shkrim për informacione që lidhen me shërbimin e shpërndarjes, furnizimit apo matjes së energjisë elektrike dhe datës së vënies në dispozicion të përgjigjes së motivuar për kërkuarin.

Neni 30

Koha e rivendosjes së furnizimit pas një defekti të sistemit të matjes

Koha e rivendosjes së furnizimit pas një defekti të sistemit të matjes të klientëve fundorë të furnizuar në tension të ulët është koha, e matur në ditë pune, regjistruar në orë dhe në minuta, ndërmjet kohës së kërkesës së klientit fundor të dëmtuar dhe kohës së rivendosjes të furnizimit me energji elektrike në pikën e matjes, e regjistruar në orë dhe minuta.

Neni 31

**Koha e kryerjes së kontrollit të sistemit të matjes
me kërkesë të klientit fundor**

Koha e kryerjes së kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit fundor është koha, e matur në ditë pune, ndërmjet datës së marrjes nga ana e shoqërisë së shpërndarjes së kërkesës për kontrollin e sistemit të matjes, të bërë nga ana e klientit fundor dhe datës së vënies në dispozicion të dokumentacionit përkatës me rezultatet e verifikimit.

Neni 32

Nivelet e cilësisë tregtare të shërbimit

Duke filluar nga 1 janari 2012, nivelet e cilësisë tregtare të shërbimit janë të përcaktuara respektivisht në tabelën 2.

Neni 33

**Rastet e mosrespektimit të niveleve të cilësisë
tregtare të shërbimit**

33.1 Rastet e mosrespektimit të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, për të cilat kompania nuk mban përgjegjësi, janë të klasifikuara si më poshtë:

- a) Për shkak të forcës madhore, sipas përcaktimeve ligjore.
- b) Për faj të klientëve fundorë apo të tretëve, të cilët nuk kryejnë veprimet e rëna dakord të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të kërkuara, ose dëme të shkaktuara nga palët e treta.
- c) Për faj të shoqërisë së shpërndarjes, që përfshin të gjitha shkaqet e tjera që nuk janë përcaktuar në gerrat “a” dhe “b” të këtij neni.

33.2 Për rastet e mosrespektimit të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, të cilat përfshihen në gerrat “a” dhe “b” të këtij neni, shoqëria e shpërndarjes dokumenton shkakun për këto raste të mosrespektimit.

Neni 34

Detyrimi për regjistrim dhe informim

34.1 Shoqëria e shpërndarjes duhet të mbajë një regjistër, në mënyrë elektronike apo manuale, të përbërë nga elementet e nevojshme, me qëllim që të regjistrojë informacionet dhe të dhënat që lidhen me kërkesat për kryerjen e shërbimeve, subjekt të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe të dhënat për kryerjen e këtyre shërbimeve.

34.2 Për çdo kërkesë për kryerjen e shërbimeve në kompetencë të saj, subjekt i niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, shoqëria e shpërndarjes duhet të regjistrojë:

- a) numrin me anë të të cilit shoqëria e shpërndarjes identifikon kërkesën për kryerjen e shërbimit;
- b) numrin me anë të të cilit shoqëria e shpërndarjes identifikon shërbimin;
- c) llojin e përdoruesit, të ndarë në klient fundor në TU familjar, klient fundor në TU jofamiljar dhe klient fundor në TM;
- d) të dhënat e kërkuarit;
- e) datën e marrjes së kërkesës për kryerjen e shërbimeve;
- f) data e kryerjes së shërbimeve;



g) shkak, në rastet e një mosrespektimi të mundshëm të niveleve të veçanta të cilësisë të parashikuara për shërbimin e kërkuar;

h) arsyeja dhe data e mundshme për përmbushjen e detyrimit të kërkuar;

i) të dhënat, n.q.s. shtyrja e detyrimit është bërë me kërkesë të klientit fundor.

Neni 35

Verifikimi i informacionit dhe i të dhënave të regjistruara

Me qëllim që të lejojë kryerjen e kontrolleve për të verifikuar vërtetësinë e informacioneve dhe të dhënave të komunikuar dhe për t'i siguruar respektimin e dispozitave të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, shoqëria e shpërndarjes:

a) duhet të mbajë regjistrin e përditësuar të informacioneve dhe të dhënave të kërkuara;

b) duhet të sigurojë verifikueshmërinë e informacioneve, të dhënave të regjistruara nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm lidhjeje edhe informatike, ndërmjet arkivave tregtare dhe arkivit teknik dhe nëpërmjet ndonjë dokumentacioni tjetër të konsideruar të nevojshëm;

c) duhet të ruajë në mënyrë të rregullt dhe të hapur për palët, të gjithë dokumentacionin, për të siguruar verifikueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave të regjistruara, për një periudhë jo më të vogël se tre vitet kalendarike pas atij regjistrimi.

Neni 36

Komunikimi tek ERE, kontrolli dhe publikimi i informacioneve dhe i të dhënave të cilësisë tregtare të shërbimit

36.1 Shoqëria e shpërndarjes komunikon në ERE informacionet dhe të dhënat për shërbimet e kryera mujore, subjekte të niveleve të cilësisë së shërbimit tregtare të shërbimit.

36.2 Brenda datës 31 mars të çdo viti, shoqëria e shpërndarjes duhet të komunikojë në ERE informacionet dhe të dhënat për shërbimet e kryera në vitin paraardhës, subjekte të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, lidhur me:

a) numrin total të kërkesave për shërbimet apo verifikimet e kërkuara dhe të kryera;

b) numrin total të kërkesave për shërbime apo të verifikimeve të kërkuara, për të cilat shoqëria e shpërndarjes nuk ka respektuar nivelet e cilësisë tregtare të shërbimit të përcaktuara, të ndara në bazë të shkakut të mosrespektimit;

c) kohën mesatare të kryerjes së shërbimeve, e llogaritur në bazë të kohës efektive të kryerjes së shërbimeve për të cilat janë respektuar nivelet e veçanta dhe të përgjithshme të cilësisë, ashtu edhe për shërbimet për të cilat ky nivel nuk është respektuar për shkaqet e përcaktuara në këtë rregullore.

36.3 Shoqëria e shpërndarjes do të publikojë gjithë këto informacione në faqen e saj të *website*.

Neni 37

Modalitetet e kryerjes së kontrollit të të dhënave të cilësisë nga ana e ERE-s

ERE ka të drejtën të kryejë kontrolle të të dhënave të cilësisë tregtare të dërguara nga shoqëria e shpërndarjes. Ajo i njofton zyrtarisht shoqërisë së shpërndarjes, datën e kryerjes së kontrollit jo më pak se 3 ditë pune përpara.

Njoftimi përmban edhe:

- a) treguesit e cilësisë tregtare të shërbimit që janë objekt i kontrollit;
- b) viti i cili do të kontrollohet (viti i cili do të kontrollohet nuk mund të jetë më i hershëm se tre vite para momentit të kontrollit dhe jo për periudhën para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje);
- c) zonat për të cilat do të kryhet kontrolli i të dhënave të cilësisë së shërbimit.

Neni 38

Kriteret e vlefshmërisë së të dhënave

38.1 Çdo tregues i cilësisë tregtare klasifikohet si i vlefshëm mbi bazën e kontrollit të kopjeve të dokumentacionit të kërkuar të mbajtur për çdo shërbim. Dokumentacioni i klasifikuar si i vlefshëm, i nënshtrohet verifikimit të konformitetit nëpërmjet këtyre kriterëve:

- korrespondenca – është koherenca ndërmjet të dhënave të mbajtura në regjistrin e shoqërisë së shpërndarjes dhe dokumenteve operative të përfundimit të shërbimit të kryer;
- saktësia e dokumentacionit – tërësia dhe saktësia e informacionit të dhënë kërkuar. Aplikohet vetëm për kërkesat për kryerjen e preventivit të punimeve në TU dhe TM;
- korrektësia e kompensimit – zbatohet për nivelet e veçanta të cilësisë së shërbimit dhe vërteton që shoqëria e shpërndarjes ka kryer me korrektesë pagesën e kompensimit ndaj klientit fundor;
- dokumentimi i shkaqeve – zbatohet në rastet e mosrespektimit të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, për mënyrën se si është dokumentuar ky shkak;
- korrektesa në kohë – është korrektesa në kohë e të dhënave të dërguara nga shoqëria e shpërndarjes dhe atyre që rillogaritet mbi bazën e dokumenteve operative.

38.2 Për informacionet e cilësisë tregtare të klasifikuara si jo të vlefshme dhe jokonform me sa është përcaktuar më sipër, shoqëria e shpërndarjes mban përgjegjësi në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar).

PJESA III

RREGULLAT E CILËSISË SË TENSIONIT

Neni 39

Stabiliteti i tensionit dhe aspektet e tjera teknike të cilësisë së tensionit

39.1 Rrjeti elektrik i shpërndarjes në kushte normale funksionon sipas normave të ndryshme të devijimit të tensionit, sipas shkallëve të ndryshme të tensionit, ndërsa frekuenca është konstante për të gjitha nivelet dhe është e barabartë me 50 Hz, me devijime +/- 2%.

39.2 Niveli i tensionit nominal është 230 V dhe mund të variojë rreth vlerave të tij nominale për një kohë më të gjatë se 10 min:

- në kryeqytet ----- +5 %/- 5%;
- në zonat urbane ----- +5 %/- 15%;
- në zonat rurale ----- + 5 %/- 20%.

39.3 Verifikimi i devijimeve të tensionit për çdo zonë, do të bëhet mbi bazë kërkesë të klientëve të energjisë elektrike.



Neni 40

Verifikimi i informacionit dhe i të dhënave të regjistruara

Me qëllim që të lejojë kryerjen e kontrolleve për të verifikuar vërtetësinë e informacioneve dhe të dhënave të kërkuara lidhur me cilësinë e tensionit, shoqëria e shpërndarjes duhet:

- a) të mbajë regjistrin e përditësuar të informacioneve dhe të dhënave të kërkuara;
- b) të sigurojë verifikueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave të regjistruara nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm lidhjeje, edhe informatike, ndërmjet arkivave tregtare dhe arkivit teknik dhe nëpërmjet ndonjë dokumentacioni tjetër të konsideruar të nevojshëm;
- c) të ruajë në mënyrë të rregullt dhe të hapur për palët, të gjithë dokumentacionin për të siguruar verifikueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave të regjistruara, për një periudhë jo më të vogël se tre vitet kalendarike pas atij regjistrimi.

PJESA IV

Neni 41

Kompensimi i klientëve

41.1 Duke filluar nga 1 janari 2012, në rast të mosrespektimit të niveleve të cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 16 të kësaj rregulloreje, shoqëria e shpërndarjes është e detyruar t'i japë një kompensim klientit fundor, me kërkesën e këtij të fundit, në vlerën 2 000 lekë.

41.2 Duke filluar nga 1 janar 2012, në rast të mosrespektimit të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 32 të kësaj rregulloreje, shoqëria e shpërndarjes është e detyruar t'i japë një kompensim klientit fundor, me kërkesë të këtij të fundit (sipas tabelës 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje).

41.3 Pas verifikimit të mosrespektimit të niveleve të cilësisë së shërbimit, shoqëria e shpërndarjes i jep klientit kompensimin, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës nga ana e tij dhe vendoset në faturën më të afërt të konsumit të energjisë elektrike.

41.4 Në faturën e dërguar, vlera e kompensimit duhet të jetë e përcaktuar nën emërtimin “Kompensim i klientit për mosrespektim të niveleve të cilësisë së shërbimit të përcaktuara nga ERE”. Gjithashtu në po të njëjtin dokument duhet të përcaktohet që “Përfitimi i kompensimit nuk përjashton mundësinë e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmshpërblimin e mundshëm për dëmin efektiv të shkaktuar”.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 janar 2012.

TREGUESIT E CILËSISË SË VAZHDUESHMËRISË SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

	Emërtimi i linjës, nënstacionit, kabinës, fiderit etj.	Shkaku i ndërprerjes				Numri i konsumatorëve të lidhur			Ndërprerje të planifikuara				Ndërprerje të paplanifikuara të shkurta (deri 3 min.)				Ndërprerje të paplanifikuara të gjata (mbi 3 min.)				SAIFI	SAIDI	Kompensimi automatik (lekë)
		Ndërprerje e planifikuar	Forcë madhore	Përgjegjësi e palëve të treta	Përgjegjësi e OSSH-së	Gjithsej	Zonë urbane	Zonë rurale	Nr. i konsumatorëve të prekur, gjithsej	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë urbane	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë rurale	Kohëzgjatja (min)	Nr. i konsumatorëve të prekur gjithsej	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë urbane	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë rurale	Kohëzgjatja (min)	Nr. i konsumatorëve të prekur, gjithsej	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë urbane	Nr. i konsumatorëve të prekur, zonë rurale	Kohëzgjatja (min)	Nr. i konsumatorëve të prekur, nga ndërprerjet/nr. i kons. gjithsej	Nr. i orëve të ndërprerjeve, gjithsej Nr. i konsumatorëve, gjithsej	
Tensioni i lartë	Linjë																						
	Nënstacion																						
	Transformator																						
	Çelës fidri 6/10/20/35																						
	Të tjera																						
Total TL																							
Tension i mesëm	Fider																						
	Kabina																						
	Klientë 20, 35 kV																						2,000
Total TM																							
Tension i ulët	Linja																						
	Lidhjet me konsumator																						
Total TU																							
TOTAL																							



TREGUESIT E CILËSISË TREGTARE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

EMËRTIMI I TREGUESIT	Klientë në TM	Klientë në TU		Dëmshpërblimi automatik
		Familjarë	Jofamiljarë	
	(ditë pune)	(ditë pune)		(lekë)
Koha e realizimit të preventivit për realizimin e punimeve në tension të mesëm dhe të ulët	15	10	10	2,000
Koha e kryerjes së punimeve të thjeshta dhe komplekse	45	30	30	2,000
Koha për aktivizimin e furnizimit me energji elektrike	3	3	3	2,000
Koha për ndërprerjen e furnizimit me kërkesë të klientëve fundorë	30	30	30	2,000
Koha për rilidhjen e energjisë elektrike për shkak të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura	2	2	2	2,000
Koha për verifikimin e cilësisë së tensionit me kërkesë të klientit fundor	9	9	9	2,000
Koha e përgjigjes për ankesat e klientëve apo kërkesat me shkrim për informacion që lidhen me shërbimin e shpërndarjes, furnizimit apo matjes së energjisë elektrike	30	30	30	2,000
Koha e rivendosjes së furnizimit pas një defekti të sistemit të matjes	1	1	1	2,000
Koha e kryerjes së kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit fundor	7	7	7	2,000

TREGUESIT E CILËSISË SË TENSIONIT

Frekuenca e lejuar	50 Hz (+/-)2 %
Tensioni nominal	230 Volt
Shmangja e lejuar e tensionit nga vlera nominale për më shumë se 10 min	
Në kryeqytet	(+/-5 %)
Në zonat urbane	(+5 %) -(+15 %)
Në zonat rurale	(+5 %) -(+20 %)

VENDIM

Nr.118, datë 18.11.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Aplikimi i “CEZ shpërndarje” sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të “CEZ shpërndarje” sh.a., për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011 për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM

Nr.119, datë 18.11.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË KESH SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012 – 2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike” Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a., për vitin 2012,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a., për planin e investimeve për vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.120, datë 18.11.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OST SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012 – 2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 9 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a., për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.121, datë 18.11.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 1, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- Në datën 1.11.2011 me shkresën nr.417/1 Prot., rezultoi e paraqitur një ankesë jashtë afatit 2-mujor të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të ERE-s, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Ankesa e sipërcituar është jashtë objektit të këtij licencimi dhe nuk prek aspak vendimmarrjen e ERE-s mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë së shoqërisë “Albanian Green Energy”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.12.2011
Doli nga shtypi më 23.12.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë